



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 31 Prot.

Durrës, më 9.01.2023

VENDIM

Nr. 1, datë 9.01 2023

**"PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË DETAJIMIT TË GRANTIT TË VITIT 2023,
PËR UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"**

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", zbatim të ligjit nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor", Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit të përbashkët të MASR dhe MFE nr. 20, datë 20.09.2019, Vendimit nr. 51, datë 08.09.2022 të Senatit Akademik "Për miratimin paraparak të PBA 2023-2025", Vendimit nr. 41, datë 14.09.2022 të Bordit të Administrimit "Për miratimin e PBA 2023-2025", Rregulloren Financiare të UAMD, shkresës 23774, datë 28.12.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për detajimin e buxhetit për vitet 2023-2025, relacionin e paraqitur nga Administrator i Universitetit, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin paraparak të detajimit të grantit të vitit 2023, për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas tabelës bashkëngjitur .
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.

KRYETARI SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI

